



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	28.01	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHCK	407/2022		1/1	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1225/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: : Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1225/2021 të datës 28.12.2021 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me Nr.01-070/03-65152 të datës 22.12.2021 të Komisionit Rekrutues të Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1225/2021 e datës 28.12.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01-070/03-65152 i datës 22.12.2021 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Drenasit dhe Njoftimi me Referencë RN00007773 i datës 22.12.2021 i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Drenasit.

A r s y e t i m

Ankuesja, fizikisht më datë 28.12.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:6357/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vlerësimit me 69.5 pikë nga Komisioni i Pranimit për pozitë "Specialit të Administrimit të Përgjithshëm" të shpallur nga Komuna e Drenasit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 31.12.2021 ankesën e ankueses e ka

proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Drenasit. Me datë 17.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Drenasit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:6357/2011 të datës 28.12.2011 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.01-070/03-65152 të datës 22.12.2021 të Komisionit Rekrutues të Komunës së Drenasit; Ankesën e ankueses e drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Komunës së Drenasit; Kërkesën për përgjigjen në ankesë e datës 31.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 17.01.2022; Konkursin për Specialist të Administrimit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 17.09.2021 për themelimin e komisionit të pranimit; Njoftimin me rezultatet për verifikimin paraprak i datës 23.11.2021 dhe 02.12.2021; Njoftimin për test me shkrim i datës 07.12.2021; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të verifikimit paraprak të kandidatëve i datës 06.12.2021; Lista e aplikantëve; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Pranimit për ankuesen; Njoftimin për intervistë me gojë i datës 10.12.2021 për ankuesen; Shkresën për intervistë me gojë e datës 15.12.2021; Aplikacionin e ankueses; Diplomën në emër të ankueses; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 03.02.2020, 31.12.2019, 15.11.2019; Referencën e datës 27.12.2019, 28.09.2021, 03.02.2020, 17.12.2014; Vërtetimin e datës 17.12.2014; Certifikatën e datës 16.11.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega Glllogoc; Shkresën për rezultatet përfundimtare të vlerësimit e datës 22.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës Komuna e Drenasit më datë 21.10.2021 ka njoftuar që nga data 11.11.2021 deri më datë 20.11.2021 fillon aplikimi për grupin e pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesja e cila është ftuar në fazat e pranimit.

Pas verifikimit paraprak nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit, ankuesja është njoftuar se është përfshirë në listë të shkurtër, dhe se testi me shkrim mbahet më datë 08.12.2021. Në bazë të vlerësimit nga Komisioni i Pranimit ankuesja në testin me shkrim ka marr 47 pikë, pastaj është ftuar në intervistën me gojë të mbajtur më datë 15.12.2021, ku në bazë të formularit të vlerësimit ka marr 7.6 pikë, ndërsa nga jetëshkrimi ka marr 15 pikë. Sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja nga ky proces i pranimit ka marr gjithsejtë 69.6 pikë.

Ankuesja kundër këtij vlerësimi më datë 17.12.2021 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit. Komisioni i Pranimit më datë 22.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.01-070/03-65152 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin që e njëjta nuk ka marr 70 pikë siç kërkohet për emërim, duke konstatuar që mbetet pranë vlerësimit të bërë.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit më datë 22.12.2021 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare të procesit të pranimit për grup "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm", pa fitues.



Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.01-070/03-65152 të datës 22.12.2021 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Drenasit, me pretendimet për rivlerësim të intervistës me gojë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses dhe duke u bazuar në të gjitha provat e lëndës, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit procedurën e pranimit për grup të pozitive për "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", e ka zhvilluar konform kompetencave të përcaktuara me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa konkursin e ka publikuar në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe nenin 9 të kësaj rregulloreje. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka bërë verifikim paraprak të kandidatëve për këtë grup pozita, duke përfshirë ankuesen në mesin e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të testit me shkrim, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesja nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme 69.6 pikë, ku në testin me shkrim ankuesja është vlerësuar me 47 pikë, në intervistën me gojë është vlerësuar me 7.6 pikë, ndërsa nga jetëshkrimi është vlerësuar me 15 pikë, si rrjedhojë neni 25 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcakton se: *"Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje"*, në rastin konkret meqenëse ankuesja në të gjitha fazat nga Komisioni i Pranimit është vlerësuar me pikë të përgjithshme 69.6 pikë, atëherë sipas nenit 25 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *"Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje"*.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar dispozitave të lartcekura lidhur me emërimin në një pozitë në shërbimin civil, konstaton se për t'u emëruar në një pozitë profesionale në shërbimin civil nevojiten së paku 70 pikë nga, andaj meqenëse ankuesja nuk ka arritur 70 pikë, atëherë edhe emërimi i saj në grupin e pozitive "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" është bërë i pamundur, kështu që pretendimi ankimor i ankueses për rivlerësim është pretendim i pabazuar sepse dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk përcaktojnë që Komisioni i Pranimit mund të bëjë rivlerësim të kandidatëve pas përfundimit të gjithë procesit, sepse ankuesja është ftuar në mënyrë të rregullt në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.01-070/03-65152 i datës 22.12.2021 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Drenasit është nxjerr në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në



Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe Njoftimi i datës 22.12.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Drenasit është në pajtim me nenin 25 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1225/2021, datë 28/01/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

